

**I** FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:  
Informacion për pacientin

# ATENOLOL

Tableta të veshura me film - 100 mg  
(*Atenolol*)

**Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.**

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

**Në këtë fletëudhëzues:**

- Çfarë është Atenolol dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Atenolol
- Si ta merrni Atenolol
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Atenolol
- Informacion i mëtejshëm

**1. ÇFARË ËSHTË ATENOLOL DHE PËRSE PËRDORET**  
Atenololi, një beta – bllokues përzgjedhës, bllokon receptorët beta1 të zemrës, të cilët ndikojnë kryesisht në sistemin kardiovaskular (ulin ritmin e zemrës, ulin kontraksionin kardiak dhe ulin presionin e gjakut); në të sëmurët me angina pectoris ai ul kërkesat miokardit për oksigjen, ul shpeshtësinë e krizave anginoze, ul nevojat për nitrite, si dhe rrit tolerancën ndaj veprimtarisë fizike. Atenololi ul presionin arterial sistolik e diastolik.

Atenolol indikohet në hipertension arterial (esencial dhe renal, i vetëm ose i kombinuar me barna të tjera); angina pectoris të shkaktuar nga arteroskleroza koronare; aritmi ventrikulare; aritmi ose takikardi supraventrikulare, infarkt akut miokardi. Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Atenolol për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Atenolol.

**2. PËRPARA SE TË MERRNI ATENOLOL**

**Mos merrni Atenolol në qoftë se:**

- jeni alergjik ndaj atenololit dhe beta-bllokuesve në përgjithësi;
- jeni alergjik ndaj ndonjërit prej përbërësve joaktivë të përmendur në fund të këtij fletëudhëzuesi;
- keni shkallë të dytë dhe të tretë të bllokut A-V;
- keni bradikardi sinusale;
- keni insuficiencë kardiake kongjestive të dekompensuar;
- keni shok kardiogjen;
- vuani nga angina Prinzmetal;
- vuani nga sindromi i sinusit të sëmurë;
- keni hipotension;
- vuani nga astma apo histori të sëmundjeve obstruktive të frymëmarrjes;
- jeni sëmurë me feokromocitomë (përveç përdorimit specifik me alfa bllokues);
- keni acidozë metabolike;
- vuani nga sëmundje të rënda të arterieve periferike;
- trajtoheni për infarkt akut të miokardit të shoqëruar me hipotension (< 100 mm Hg);
- vuani nga sindromi Raynaud.

Ndërprerja e menjëhershme e trajtimit me atenolol është e kundërrindkuar në të sëmurët kardiakë.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos i merrni tabletat, shkoni dhe flisni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

**Tregoni kujdes të veçantë me Atenolol**

Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se:

- jeni alergjik ndaj barnave të tjera, veçanërisht në qoftë se janë në të njëjtën klasë barnash me Atenolol;
- jeni ose keni në plan të ngeleni shtatzënë gjatë kohës që jeni duke përdorur Atenolol;

- jeni duke ushqyer foshnjen me gji ose po planifikoni të ushqeni foshnjen me gji;
- vuani nga angina pectoris (Atenolol nuk duhet ndërprerë menjëherë gjatë trajtimit të angina pectoris; ndërprerja e menjëhershme mund të shkaktojë çrregullime të rënda të ritmit, infarkt miokardi dhe vdekje të menjëhershme);
- vuani nga insuficienca koronare (këshillohet që sikurse edhe për të gjithë beta-bllokuesit, doza të ulet gradualisht);
- vuani nga astma bronkiale dhe sëmundje të tjera të mushkërive (bronkit, emfizemë); beta-bllokuesit kardioselektivë si Atenolol mund të përdoren me shumë kujdes vetëm kur nuk ka alternativë tjetër mjekimi sepse ekziston rreziku i shfaqjes së bronkospazmave akute, sidomos kur përdoren doza të larta;
- keni probleme të përcimit (bllok A – V i shkallës së parë), sepse ai jep efekt deprimues në përcueshmërinë e zemrës;
- vuani nga hipertensioni portal (rrezik i përkeqësimit të funksionit të mëlçisë);
- vuani nga hipertiroidizmi ose nga tirotoksikozja, sepse Atenolol mund t'i maskojë shenjat e hipertiroidizmit dhe simptomat në të sëmurët që dyshohen për tirotoksikozë;
- vuani nga diabeti sepse Atenolol mund t'i maskojë simptomat e hipoglicemisë dhe prandaj duhet përdorur me kujdes;
- vuani nga psoriaza, depresioni apo miastenia gravis;
- vuani nga sëmundje të veshkave ose të mëlçisë; doza fillestare duhet ulur;
- i sëmurë është i moshuar;
- jeni alergjikë, sepse Atenolol mund të rrisë ndjeshmërinë ndaj alergjenëve duke shkaktuar një reaksion mbindjeshmërie më të rëndë se zakonisht dhe mund të reduktojë përgjigjen ndaj adrenalinë;
- do t'i nënshtroheni një ndërhyrjeje kirurgjikale dhe po përdorni Atenolol. Beta-bllokuesit duhen ndërprerë 24-48 orë para ndërhyrjes. Është me rëndësi që anestezisti të jetë në dijeni të përdorimit të beta-bllokuesve.

Pacientët që trajtohen për një kohë të gjatë me një beta-bllokues duhet ta ndërpresin trajtimin gradualisht përgjatë 1 ose 2 javëve.

**Marrja e barnave të tjera**

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë se fundmi barna të tjera, edhe ato pa recetë. Përdorimi në të njëjtën kohë i atenololit me kalçibllokues mund të shkaktojë: rritje të rrezikut për bradikardi dhe bllok atrio-ventrikular me diltiazemin; hipotension të rëndë dhe insuficiencë kardiake me nifedipinën; asistoli, hipotension të rëndë dhe insuficiencë kardiake me verapamilin. Përpara se të fillohet trajtimi me atenolol është e nevojshme të kenë kaluar të paktën 48 orë nga ndërprerja e verapamilit apo diltiazemit dhe e anasjellta. Simptomimetikët mund të shkaktojnë një antagonizim të ndërsjellë dhe për rrjedhojë edhe uljen e efektit të tyre. Efekti hipotensiv antagonizohet edhe nga kortikosteroidët dhe estrogenët.

Nga përdorimi në të njëjtën kohë i atenololit dhe i klonidinës mund të shfaqet bradikardi dhe deprimim i rëndë i zemrës. Nëse këto dy barna administrohen njëkohësisht, terapia me atenolol duhet ndërprerë shumë ditë përpara ndërprerjes graduale të klonidinës; nëse atenololi zëvendëson terapinë me klonidinë, administrimi i tij duhet të fillojë disa ditë pas ndërprerjes së klonidinës.

Disa antiinflamatorë josteroidë mund ta ulin efektin antihipertensiv të atenololit.

Prazosina mund ta rrisë rrezikun për hipotension ortostatik. Ampicilina mund ta ulë efektin antihipertensiv dhe antianginoz të atenololit.

Përdorimi në të njëjtën kohë i atenololit me insulinën mund ta vështirësojë kontrollin e diabetit. Amiodaroni mund të shkaktojë: bradikardi, bllok atrioventrikular dhe depresion të miokardit kur merret së bashku me beta-bllokues. Kujdes duhet treguar edhe nga marrja në të njëjtën kohë e antiaritmikëve të klasës së parë. ACE-inhibitorët (frenuesit e enzimës së konversionit të angiotenzinës), alkooli, alfa-bllokuesit, anestetikët e përgjithshëm, bllokuesit e receptorëve të angiotenzinës II, MAO-inhibitorët, fenotiazinat, anksiolitikët dhe hipnotikët, diuretikët dhe nitratet mund të përforcojnë efektin hipotensiv të tij. Glikozidet kardiake rrisin rrezikun për bllok atrioventrikular dhe bradikardi nëse merren njëkohësisht me atenololin. Moksilisiliti mund të shkaktojë hipotension postural të rëndë nëse merret njëkohësisht me atenololin. Fingolimodi rrit rrezikun për bradikardi kur merret njëkohësisht me atenololin.

Këto barna mund të ndikohen nga Atenolol ose mund të ndikojnë në mënyrën se si ai vepron, ndaj në përdorimin e njëkohshëm të tyre është nevoja të ulet ose të rritet doza e atenololit. Mjeku ose farmacisti juaj do t'ju këshillojë.

**Marrja e Atenolol me ushqim dhe pije**

Alkooli mund të ndërveprojë me Atenolol duke zmadhuar efektin hipotensiv, ndaj nuk duhet konsumuar gjatë kohës së mjekimit.

**Shtatzënia**

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë. Përdorimi i Atenolol duhet të shmanget gjatë shtatzënisë.

Mjeku ose farmacisti do të diskutojnë mbi rreziqet dhe përfitimet e marrjes së këtij bari gjatë shtatzënisë.

**Ushqimi me gji**

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjen me qumësht gjiri. Atenolol kalon në qumështin e gjirit në përqëndrim të njëjtë ose më të lartë se përqëndrimi plazmatik tek nëna. Duhet shmangur përdorimi i atenololit gjatë ushqyerjes me gji sepse mund të shkaktojë bradikardi dhe efekte të tjera anësore tek foshnja. Mjeku ose farmacisti do të diskutojnë mbi rreziqet dhe përfitimet e marrjes së këtij bari në qoftë se jeni duke ushqyer foshnjen me gji apo keni në plan të bëni këtë.

**Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive**

Tregohuni të kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit ose përdorimit të makinerive derisa të shihni se si Atenolol ndikon tek ju sepse ai mund të shkaktojë edhe turbullime të të parit dhe mund të ndikojë në aftësitë për të drejtuar automjetin ose për të punuar me makineri.

**3. SI TA MERRNI ATENOLOL**

Gjithmonë merreni Atenolol vetëm sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se ndjeni që efektet e Atenolol janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Këshillojmë që tabletat t'i merrni në të njëjtën orë çdo ditë. Tabletatat Atenolol duhet të gëlltiten të plota me një gotë ujë.

Dozimi i Atenolol është si më poshtë:  
*në hipertensionin arterial:* 50 - 100 mg në ditë, megjithëse 50 mg zakonisht është e mjaftueshme. Efekti i plotë është i dukshëm brenda 1-2 javëve.  
*në profilaksinë e krizës anginoze:* 50 - 100 mg në ditë si dozë e vetme ose në doza të ndara.  
*në trajtimin e aritmive:* 50 - 100 mg në ditë.  
*në infarkt miokardi:* trajtimi duhet filluar brenda 12 orëve pas fillimit të dhimbjes së gjoksit. Atenololi duhet të jepet fillimisht si injeksion intravenoz i ndjekur nga doza orale 50 mg – 100 mg në ditë.

Në funksion renal të dëmtuar

Në pacientë me funksion renal të dëmtuar kërkohen doza të reduktuara.

Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni të sigurt për mënyrën e përdorimit.

**Në qoftë se keni marrë më shumë Atenolol**

Në qoftë se keni marrë më shumë Atenolol se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

**Në qoftë se harroni të merrni Atenolol**

Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.

**Në qoftë se ndërprisni trajtimin me Atenolol**

Pacientët që trajtohen për një kohë të gjatë me një beta-bllokues duhet ta ndërpresin trajtimin gradualisht përgjatë 1 ose 2 javëve. Ndërprerja e menjëhershme e beta-bllokuesve mund të përkeqësojë anginën dhe mund të shkaktojë vdekje të papritur. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

**4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME**

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre. Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme ju shqetëson:

- në sistemin kardiovaskular (bradikardi, hipotension i theksuar, shkallë e dytë ose e tretë e bllokut A – V, insuficiencë kardiake, vazokonstriksion periferik, ftohje në anësitë, të fikët;

ndërprerja e menjëhershme e beta-bllokuesve mund të përkeqësojë anginën dhe mund të shkaktojë vdekje të papritur);

- në sistemin e frymëmarrjes (bronkospazma, dispne);
- në sistemin nervor qendror (pagjumësi, konfuzion dhe çrregullime të gjumit duke përfshirë makthet, dhimbje koke, lodhje, marrje mendsh, depresion, haluçinacione, letargji, përgjumje, e folur jo e qartë; efekte më të rralla periferike janë parestezia, neuropatia periferike);
- në aparatin tretës (të përziera, të vjella, diarree, konstipacion, krampe abdominale);
- në aparatin urogenital (impotencë, urinim me vështirësi ose i shpeshtë);
- në sistemin hematopoetik (agranulocitozë, purpura, trombocitopeni);
- turbullimi i të parit, tharje e syve;
- zhurmë në veshë;
- rash në lëkurë, kruarje, përkeqësim i psoriazës, ekzantema, alopeci;
- ndryshime në peshë, edemë në fytyrë, dobësi muskulore;
- hiperglicemi, hipoglicemi, hiperlipidemi;
- antitropa antinukleare.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

**5. SI TA RUANI ATENOLOL**

Mbajeni larg fëmijëve!  
Mos e përdorni Atenolol pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.  
Ruajeni nën temperaturën 25°C!  
Ruajeni në paketimin original për ta mbrojtur nga drita dhe nga lagështia!

**6. INFORMACION I MËTEJSHËM**



**Çfarë përmban Atenolol – Tableta të veshura me film 100 mg**  
**Lënda vepruese** është atenolol.  
Çdo tabletë e veshur me film përmban 100 mg atenolol.  
**Përbërësit e tjerë** janë: karbonat magnezi, celulozë mikrokristalore, amidon, laurilsulfat natriumi, stearat magnezi, glikolat natriumi i amidonit, talk, povidon (K-30), Opadry II portokalli.


**Përmbajtja e paketimit**

Kuti me 30 tableta të veshura me film.

**Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:**

 Sipas recetës së mjekut.

 Përmbajtja.  Kujdes.

 Forma e tabletës.

**Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:**

 **PROFARMA Sh.a.**  
Rruga "Myslym Keta"  
Tel.: 00355 4 23 89 602  
Tiranë - SHQIPËRI

**Ky fletëudhëzues u formulua për herë të fundit në Qershor 2012.**